



Ditën e Hënë, datë 04 Qershor 2012, ora 18:00, pranë Kinema Millenium, do të organizohet shfaqja e dokumentarit "Piero Guccione drejt pafundësisë" i realizuar nga regjisori italian NUNZIO MASSIMO NIFOSI

Ditën e Mërkurë, datë 06 Qershor 2012, ora 11:00 në sallën Black BOX, do të organizohet takimi me studentët dhe me regjisorin e dokumentarit për një orë të hapur diskutimi.

“Piero Guccione, oltre pafundësisë”, dokumentar i Nunzio Massimo Nifosi

Prezantim : **“Piero Guccione, përtej pafundësisë”** është një dokumentar kushtuar një prej figurave më të rëndësishme të artit bashkëkohor.

“Poesia picta”, kështu e përshkruan atë kritiku i artit Murizio Calvesi duke marrë shkas nga piktura e mjeshtrit Sicilian.

Piero Guccione (lindur më 1935), edhe sot, pas njëshekulli e gjysëm nga debutimi i tij i parë, sjell art të kulluar. Mund të konfirmohet se vepra e tij vazhdon të ketë ende sukses dhe të vlerësohet gjithnjë e më shumë.

Cilido të ketë qenë inspiruesi (metropolitan, natyror, letrar, artistik...), Guccione e tregon gjithnjë me lirizëm dhe, në disa raste, me shpirt kritik.

Përsa i përket krijimtarisë *guccioniane*, kështu siç e ka cilësuar gjithmonë kritika ndërkombëtare, bëhet fjalë për art absolut, për shumë aspekte i lëkundshëm mes figuratives, realizmit magjik dhe “informales”. Një pikturë që arrin të filtrojë shikimin dhe ndjeshmërinë e vëzhguesit, deri sa të rrënjoset në imagjinatën e tij.

Nuk është e rastit nëse sot, në fushën e artit (dhe jo vetëm), kur dërgohet ndërmend deti, mendohet pothuajse gjithnjë ai i pikturuar nga Piero Guccione, në format e ndryshueshme dhe variacionet e tij.

Një pikturë e tij e famshme e 2003-shit ka për titull “Lëvizjet e detit”. Vepra mund të titullohet edhe “Lëvizjet e shpirtit”, të njëjtat që lindin tek ai që vështron vera e mjeshtrit siçilian. Lëvizje të brendshme, horizonte të zhdukura, ngjyra shtangëse, rrugëtime ëndërruese; vrojtimi bëhet soditje, perceptim...dritë.

Nëse është e vërtetë që artisti në fjalë është hirësuar nga kritika më autoritare dhe nga më të vëmendshmit e të apasionuarve pas artit, është gjithashtu e vërtetë se të qenurit i druajtur, bërja e një jete të rezervuar dhe zgjedhja për të jetuar larg nga “qarqet e mëdha artistike”, kanë kufizuar, pjesërisht, njohjen e këtij poeti të madh të dritë – hijes.

Shënime të regjisë

Struktura treguese e dokumentarit është ndërtuar nga elemente të ndryshme dhe karakterizohet për gershetimin e disa vendeve dhe koheve të ndryshme.

Tregimi i nje dite nga jeta e Piero Guccione eshte preteksti filmik per te kuptuar illese e metodes se tij te punes dhe lidhjet e tij me ate c’ka e rrethon.